



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.174/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohen** si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.174/2014 dhe Anr.176/2014 të datës 05.06.2014 dega në Prizren, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1650 (njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 05.06.2014, ka pranuar ankesat Anr.174/2014 dhe Anr.176/2014, nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014, subjekti politik PDK, ka vendosur posterët e kandidatit të tyre për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në rrugë publike.

- Sipas ankesës Anr.174/2014, pretendohet se me datën 05 qershor 2014 aktivistja e Lëvizjes Vetëvendosje nga Qendra në Prizren, në ora 14:15 kanë vërejtur se mbi rrugën “ Ismet Jashari-Kumanova” në qytetin e Prizrenit kanë vendosur posterët e kandidatit Naser Berisha nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik PDK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur dy fotografi.
- Sipas ankesës Anr.176/2014, pretendohet se me datën 05 qershor 2014 rreth orës 14:10 aktivistja e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) nga Qendra në Prizren, kanë vërejtur se mbi rrugën “ De Rada” në qytetin e Prizrenit, është vendosur poster i kandidatit Naser Berisha nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik PDK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Lidhur me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur një fotografi.

- PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarri masat përmirësuese lidhur me ankesat më datën 05.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesave deri më datë 06.06.2014 në ora 17:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjet e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se aktivistët e PDK-së në Prizren kanë ndërmarri të gjitha masat përmirësuese dhe kanë hëkjur posterin e kandidatit për deputet Naser Berisha të vendosura mbi rrugë publike për të cilën është parashtruar ankesa brenda afatit të përcaktuar kohor. Përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur fotografitë me të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterit nga vendi që është bërë shkelja e pretenduar në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK Naser Berisha është vendosur mbi rrugë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë

lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit të saj janë të vendosura mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.174/2014 më datën 08.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoja e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*